15012

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Lartë i Drejtësisë
Sekretari i Përgjithshëm

Bulevardi "Zogu I", Tiranë. *Tel: +3554 2259817, Fax: +3554 2259822* *www.kld.al*

Nr3267/1 Prot. Tiranë, më 27.10.2015

L ë n d a : Kthim përgjigje.

Drejtuar: **Z. Dorian MATLIJA**
Qendra "Res publika", Drejtor Ekzekutiv
Adresa: Rruga "Nikolla Tupe", Pall. 4, Shk. 1, Ap. 5,

TIRANË

I nderuar z. Matlija,

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e organizatës, në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3267 prot., datë 12.10.2015, për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit, ju informojmë se pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë është paraqitur kërkesa e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 2668 prot. dhe nr. 2669 prot., datë 29.07.2014 si dhe kërkesën nr. 2692 prot., datë 30.07.2015, për verifikimin e veprimtarisë gjyqësore të tre gjyqtarëve. Duke pasur në konsideratë i) ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" e cila njeh të drejtën e kujtdo për të pasur informacion, si dhe ii) dokumentacioni i grumbulluar gjatë verifikimit ka të dhëna konfidenciale dhe ndonjëherë sensitive, që mbrohen nga legjislacioni në fuqi, lutemi gjeni më poshtë ecurinë e trajtimit të këtyre kërkesave nga Inspektorati Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Lidhur me verifikimin e veprimtarisë gjyqësore të gjyqtares Igerta Hysi, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për mosrespektim formal të ligjit, nga verifikimi i kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi bazën e urdhrit nr. 2654/1, datë 05.08.2014 është konstatuar se gjyqtarja Igerta Hysi me vendimin nr. 62-2014-2681(754), datë 15.07.2014 ka refuzuar kërkesën e prokurorit për zgjatjen e afatit të paraburgimit ndaj të arrestuarit A.I. për efekt ekstradimi. Gjyqtarja me vendimin nr. 62-2014-2681(762), datë 16.07.2014 ka vendosur shuarjen e masës së sigurisë "arrest me burg" ndaj tij. Prokuroria ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. 285, datë 15.08.2014 dhe vendimin nr. 286,

datë 15.08.2014 ka vendosur lënien në fuqi të të dyja vendimeve të dhëna nga gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Fier Igerta Hysi. Është ushtruar e drejta e rekursit nga prokurori, më datë 15.09.2014, duke kaluar kjo çështje për vendimmarrje në Gjykatën e Lartë.
Për sa më sipër Inspektorati ka konkluduar që ankesa të mbahet në verifikim deri në përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me verifikimin e veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit Laurent Fuçia, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga verifikimi i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi bazën e urdhrit nr. 2646/1 prot, datë 04.08.2014 është konstatuar se gjyqtari Laurent Fuçia me vendimin penal nr. 327, datë 16.07.2014 ka vendosur pranimin e kërkesës, revokimin e masës së sigurimit personal "arrest me burg" duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të të pandehurit Erjon Sadikaj. Këtij të pandehuri, me vendimin nr. 285, datë 11.10.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë i është dhënë masa e sigurimit "arrest në burg" dhe Gjykata e Lartë me vendimin nr. 002012-1493, datë 22.11.2012 ka vendosur mospranim të rekursit të ushtruar kundër vendimit nr. 285, datë 11.10.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Në vijim, më datë 27.02.2014 është ekzekutuar masa e sigurimit "arrest me burg" e lënë në fuqi me vendimin e mësipërm.

Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 4, datë 05.02.2014 ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 1473, datë 15.11.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Ky vendim lidhet me miratimin e ekstradimit të shtetasit Erjon Sadikaj dhe jo me kërkesën për revokim të masës së sigurimit. Aktualisht çështja është në Gjykatën e Lartë për gjykim.

Në vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 285, datë 11.10.2012 gjyqtari nuk ka disponuar mbi vendimin nr. 227, datë 02.05.2012, por me këtë vendim ka vendosur ndryshim të vendimit nr. 441, datë 09.08.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rrëzimin e kërkesës për revokim të masës së sigurimit "arrest në burg" e vendosur për efekt ekstradimi. Vendimi nr. 441, datë 09.08.2012 është marrë po nga gjyqtari Laurent Fuçia i cili ka revokuar masën e sigurimit "arrest në burg". Në arsyetimin e vendimit gjyqtari i referohet dispozitave procedurale lidhur me kohëzgjatjen e masave shtrënguese për efekt ekstradimi. Pavarësisht se kryetarja e Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal nr. 93, datë 05.07.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë, ky urdhërim nuk mund të shërbejë si shkak për revokimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg". Mungesa e njërit prej rasteve të shprehura në mënyrë eksplicite në ligj është shkak që e bën të pabazuar vendimin e gjykatës. Gjykata bën interpretimin e ligjit, por nuk mund të krijojë ligj duke krijuar raste shtesë për shuarjen apo revokimin e masës së sigurimit në ekstradim.

Nga sa më sipër, është vlerësuar se vendimi nr. 327, datë 16.07.2014 është dhënë në kundërshtim me normat procedurale penale. Megjithatë, për të arritur në një konkluzion të qartë e të

padyshimtë është çmuar e nevojshme mbajtja e ankesës në verifikim në vijim deri në përfundimin e gjykimit në Gjykatë të Lartë, ndaj rekursit të paraqitur nga i pandehuri Erjon Sadikaj kundër vendimit nr. 824, datë 16.12.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Lidhur me këtë qëndrim është bërë me dije edhe Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 2646/10 prot., datë 27.03.2015 prot..

Lidhur me ankesën e Prokurorisë së Përgjithshme për mosrespektim formal të ligjit gjatë veprimtarisë gjyqësore nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Alma Liçaj, Gjinovefa Gaba dhe Skënder Damini për dhënien e vendimit nr. 70, datë 20.02.2014, ju bëjmë me dije se me shkresën nr. 2659/1 prot., datë 04.08.2014, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, mbështetur në Memorandumin e Bashkëpunimit midis dy institucioneve tona "Për harmonizimin e procedurave të inspektimit gjyqësor dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave", për të shmangur mbivendosjen e verifikimeve, e ka përcjellë pranë ministrisë së Drejtësisë, pasi ajo kishte filluar më parë verifikimin e saj. Me shkresën nr. 79/17 prot., datë 05.09.2014 ministria e Drejtësisë informon KLD-në se rezultatet e inspektimit të nisura nga ana e saj do të na bëhen me përfundimin e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë.

Duke ju falenderuar mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

PJERIN PRENDI